



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KUKËS

KRYETARI

**URDHËR**

Nr. 73, datë 02.02.2021

*Për*

***"Miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm të Bashkisë  
Kukës"***

Në mbështetje të nenit 8/2, 9/1/1.1/b dhe nenit 64, të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 4, pika 13, të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik", si dhe Urdhërit nr.100, datë 25.10.2016, për "Miratimin e manualit të auditimit të brendshëm në sektorin publik" (i ndryshuar),

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Kodit të Etikës për Audituesit e Brendshëm të Bashkisë Kukës, bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Drejtoria e Auditit të Brendshëm për zbatimin e këtij urdhëri.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**  
**Safet GJICI**



**BASHKIA KUKËS**  
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

**KODI I ETIKËS**  
**PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM NË BASHKINË KUKËS**

Kodi i Etikës, i bazuar në Kodin e Etikës për Audituesin e Brendshëm në Sektorin Publik, miratur me urdhër Nr.86, datë 10.12.2015 të Ministrit të Financave, si dhe në Kodin e Etikës të Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm (IIA), përmban parimet që rregullojnë sjelljen e audituesve të brendshëm në njësitë publike në kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm. Ky dokument përshkruan kërkesat minimale për sjelljen dhe pritshmëritë e sjelljes të audituesve të brendshëm, pra nuk përfshin aktivitete të veçanta të veprimtarisë audituese.

**I. QËLLIMI I KODIT TË ETIKËS**

Kodi i Etikës ka për qëllim të promovojë një kulturë etike në profesionin e auditimit të brendshëm. Kodi i Etikës është i nevojshëm dhe i përshtatshëm për profesionin e auditimit të brendshëm, i krijuar për të vendosur besimin dhe sigurimin objektiv në lidhje me qeverisjen, menaxhimin e riskut dhe kontrollin.

Auditimi i brendshëm është një veprimtari e pavarur, që jep siguri objektive, si dhe ofron këshillim për menaxhimin, e projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar veprimtarinë e njësisë publike. Auditimi i brendshëm ndihmon njësinë publike për të arritur objektivat, nëpërmjet një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit dhe të qeverisjes.

Ky kod, shtrihet përtej Përkufizimit të Auditimit të Brendshëm dhe përfshin dy komponentë kryesorë:

- 1. Parimet** – të rëndësishme për profesionin dhe praktikën e auditimit të brendshëm;
- 2. Rregullat e Sjelljes** – norma të sjelljes që pritet të zbatohen nga audituesit e brendshëm.

Këto rregulla ndihmojnë në interpretimin e parimeve për zbatimin praktik të tyre dhe kanë si qëllim të udhëzojnë sjelljen etike të audituesve të brendshëm.

Auditues i brendshëm, është profesionisti, i kualifikuar dhe çertifikuar sipas kërkesave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe që kryen shërbimin e auditimit të brendshëm, në përputhje me përkufizimin e auditimit të brendshëm.

**KODI I ETIKËS PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM**

## **II. FUSHA E VEPRIMIT**

Kodi i Etikës, zbatohet për audituesit e brendshëm në Bashkinë Kukës.

Për të gjithë audituesit e brendshëm të certifikuar në detyrë të Bashkisë Kukës, shkeljet e Kodit të Etikës do të vlerësohen dhe administrohen sipas akteve ligjore në fuqi.

## **III. PARIMET DHE RREGULLAT E SJELLJES**

### **A. Parimet e Kodit të Etikës**

Kodi i etikës bazohet në katër parime bazë të sjelljes profesionale: konfidencialiteti, objektiviteti, kompetenca, dhe integriteti. Audituesit e brendshëm pritet që të zbatojnë dhe respektojnë këto parime:

- **Integriteti**  
Integriteti i audituesve të brendshëm formon dhe vendos besim ndaj përbën bazën e besueshmërisë së gjykimit të tyre.
- **Objektiviteti**  
Audituesit e brendshëm tregojnë nivelin më të lartë të objektivitetit profesional ndërsa mbledhin, vlerësojnë dhe komunikojnë informacion mbi aktivitetin apo procesin e audituar. Audituesit e brendshëm bëjnë një vlerësim të ekuilibruar të gjithë rrethanave dhe vendimet e tyre nuk ndikohen padrejtësisht nga interesat personale apo nga palë të tjera.
- **Konfidencialiteti**  
Audituesit e brendshëm respektojnë vlerën dhe pronësinë e informacionit që marrin dhe nuk e shpërndajnë këtë informacion pa pasur autoritetin e kërkuar, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj apo nga detyrimet profesionale.
- **Aftësia**  
Audituesit e brendshëm kanë njohuritë, aftësitë dhe përvojën e nevojshme për kryerjen e shërbimeve të auditimit të brendshëm.

### **B. Rregullat e sjelljes**

Rregullat e sjelljes udhëzojnë se si parimet e sipërmendura zbatohen në praktikë. Qëllimi i tyre është të drejtojnë audituesit e brendshëm të kenë një sjellje etike.

## Rregullat e sjelljes

### **1. Integriteti**

Audituesit e brendshëm duhet të:

- 1.1. Punojnë me ndershmëri, zell dhe përgjegjshmëri.
- 1.2. Respektojnë ligjin dhe të japin informacion atëherë kur kërkohet nga ligji dhe profesioni.
- 1.3. Mos jenë, me dijeni e tyre, pjesë e ndonjë aktiviteti të paligjshëm apo të angazhohen në veprime që dëmtojnë profesionin e auditimit të brendshëm ose organizatën e tyre.
- 1.4. Respektojnë dhe të kontribuojnë në përmbushjen e objektivave të ligjshëm dhe etikë të organizatës.

### **2. Objektiviteti**

Audituesit e brendshëm duhet të:

- 2.1. Mos marrin pjesë në ndonjë aktivitet apo marrëdhënie që mund të ndikojë ose që mund të supozohet se ndikon në dhënien e një vlerësimi të paanshëm. Këtu përfshihen edhe ato aktivite ose marrëdhënie që mund të jenë në konflikt interesi me organizatën.
- 2.2. Mos pranojnë asgjë që mund të ndikojë ose që mund të supozohet se ndikon në gjykimin e tyre profesional.
- 2.3. Tregojnë të gjitha faktet e njohura që, në rast se nuk tregohen, mund të shtrembërojnë raportimin e aktiviteteve të shqyrtuara.

### **3. Konfidencialiteti**

Audituesit e brendshëm duhet të:

- 3.1. Tregojnë kujdes me përdorimin dhe mbrojtjen e informacionit të mbledhur gjatë kryerjes së detyrave të tyre.
- 3.2. Mos përdorin informacion për përfitim personal apo për çfarëdolloj qëllimi që është në kundërshtim me ligjin apo në dëm të objektivave ligjore dhe etikë të organizatës.

### **4. Aftësia**

Audituesit e brendshëm duhet të:

- 4.1. Angazhohen vetëm në ato shërbime për të cilat kanë njohurinë, aftësitë dhe përvojën e duhur.
- 4.2. Kryejnë shërbimet e auditimit të brendshëm në përputhje me Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm (Standardet).
- 4.3. Përmirësojnë vazhdimisht profesionalizimin e tyre si dhe efektivitetin dhe cilësinë e shërbimeve të tyre.

*Audituesit e brendshëm, të cilët punojnë në sektorin publik, përveç njohjes së kërkesave të këtij Kodi Etik, duhet të kenë parasysh dhe legjislacionin në fuqi për rregullat e etikës në administratën publike.*

**DREJTUESI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

**SELMAN SPAHIU**

**KODI I ETIKËS PËR AUDITUESIT E BRENDSHËM**